

FJALA E DEPUTETES ORJOLA PAMPURI

E ENJTE 21 KORRIK 2022

Të nderuar kolegë,

E nderuara kryesuese e seancës,

Në fakt, përpara se të nis fjalën time, kaluan disa orë nga fillimi i seancës, dhe t'ju them të drejtën, nga çfarë kam parë nëpër rrjetet sociale dhe portale, pasi atë moment nuk isha prezente në sallë, sjellja e Kryeministrit vlen vërtet të përmendet, sepse lë shumë për të dëshiruar. Meqenëse sot është seanca e fundit e këtij sesioni, do t'ju lutesha që të gjitha frustrimet e gjithkujt të mos manifestohen më me sjellje vulgare nga askush. Këtu ka zonja të nderuara, pa diskutim ka edhe zotërinj të nderuar nga të dyja krahët, të cilët për asnjë arsye nuk duan as të dëgjojnë e as të jenë prezentë në sjellje të tilla hiçfare normale, për të cilat duhet t'i vijë zor edhe vetë Kryeministrit, por edhe neve që jemi këtu, në këtë sallë, që sigurisht nuk ndjehemi mirë.

Sa i përket çështjes për të cilën po flasim, e drejta për t'u informuar përbën një ndër parimet e demokracisë. Autoriteti i Dosjeve, përmes sfidave, ka arritur të nxjerrë në pah të vërteta, fatkeqësisht gjithnjë të hidhura për të afërmit, miqtë, familjarët, por ndërkohë ka hedhur dritë mbi portrete personazhesh, të cilët janë shuar, sepse me ndriçimin e tyre verbonin dritëhumburit, ata që për të mbijetuar qëndronin qosheve të pallateve, duke spiunuar, për të nxirë jetë dhe të ardhmen e dikujt që kish zgjeshur të jetonte një jetë ndryshe nga e tyrja, me një jetë mundi, sakrifice, dijeje, dinjiteti dhe integriteti, ndryshe nga ta njerëz të denigruar, që kacavireshin duke bërë spiunllëqe, që kënaqnin egon e tyre patologjike përmes shpifjesh, spiunimesh e shantazhimesh ndaj njerëzve të ndershëm.

Në një botë të lirë, në demokraci vlerësohet çdo mendim ndryshe, ndërsa në diktaturë jo. Kjo mendësi duhet të marrë fund një herë e përgjithmonë. Sot e vlerësova punën e këtij instituti, e Autoritetit të Dosjeve, sepse ky institucion ka ndihmuar shumë familje, që të mësojnë të vërtetat e hidhura, por sigurisht ka ndihmuar edhe shoqërinë tonë që të mësojë emra, të cilët

pas triumfeve të tyre fshehin një të shkuar si bashkëpunëtorë të suksesshëm të Sigurimit të Shtetit, që pikërisht falë këtij misioni ogurzi kanë hedhur hapat e parë në sukseset e tyre. Së bashku me disa nga anëtarët e këtij institucioni, vitin e kaluar patëm kënaqësinë të vizitonim në Poloni një institut të ngjashëm me atë të Autoritetit të Dosjeve sot, por që sigurisht shumë më të zhvilluar dhe me më shumë hapa përpara, sigurisht, siç e dimë shumë mirë, për shkak të buxhetit.

Patëm fatin të shikonim se si kishte funksionuar ky institut dhe, sigurisht, kur erdhëm këtu, së bashku me kolegë nga maxhoranca, së bashku me një ekip të shkëlqyer që ka ky Institut, patëm mundësinë të diskutonim se sa të nevojshëm e ka Shqipëria një institucion të tillë. Sepse duhet të kuptojmë një gjëm në shpesh e kemi thënë dhe e kemi përmendur se sa të nevojshme janë këto informacione për shqiptarët, se sa të nevojshme janë këto informacione për brezin e ri, sa të nevojshme janë që sot në kurrikulat e shkollës t'i mësohet këtij brezi se çfarë ka kaluar ky vend në 50 vjet diktaturë, t'i mësohet atij brezi të ri se sa e egër ka qenë diktatura në këtë vend. Sepse, tek e fundit, duhet të kuptojmë nëse historia harrohet, ka gjasa që ajo të përsëritet.

Ndërsa ne sot, sigurisht, ndihemi mirë edhe me hapat e ndërmarrë nga ky Institut, por, nga ana tjetër, ndiejmë një keqardhje tjetër, pasi në 32 vjet nuk arritëm dot të dënonim asnjë ishsigurims, asnjë persekutor, asnjë prokuror. Absolutisht asnjë. Ata bashkëjetuan me ne. Ata u ndanë nga kjo jetë të lumtur, pa pasur asnjë gjemb në këmbë, ndërkohë që firmosën për të pushkatuar, për të internuar dhe për të burgosur me qindra, mijëra njerëz të pafajshëm, intelektualë, të cilët kërkonin t'i jepnin shumë këtij vendi. Ajo që vlen të theksohet është, me thënë të drejtën, e dhimbshme. I lamë ish-të përndjekurit rrugëve, duke kërkuar lëmoshë për ato palo shpërblime që për 32 vjet u kemi thënë: "Morët kaq, morët aq, nesër ndahet kësti tjetër, vitin tjetër kësti tjetër".

Në fakt, nuk kemi bërë gjë tjetër, veçse i kemi tallur. Nuk arritëm t'i vlerësojmë me dinjitet, pikërisht atë dinjitet i cili i ndihmoi të shihnin shpresë për vite me radhë nga ajo rreze e hollë e dritës që arrinte të depërtonte në dritaren e qelisë së burgut. Sa e sa të tjerëve sot nuk u gjenden kockat. Dhe pikërisht sot Shqipëria ka nevojë për një realitet ndryshe. Ka nevojë për një buxhet të veçantë, pikërisht për atë që folëm më parë, për të gjetur trupat e sa e sa të

zhdukurve të pushkatuar pa gjyq, dhe ka nevojë për një nismë madhore, hapjen e dosjeve për të gjithë ne këtu dhe ata që do të jenë nesër pjesë e politikës. Partia Demokratike do të ndërmarrë një nismë ligjore që synon deklasifikimin e plotë të dosjeve të Sigurimit të Shtetit për periudhën 1945-1990. Le ta ndërmarrim më në fund këtë iniciativë të gjithë së bashku.

Të jeni të sigurt se do të ndërtojmë një shtet të vërtetë, një të ardhme të vërtetë, do të jemi edhe më të vërtetë përballë votuesve dhe, mbi të gjitha, do të fshijmë njëherë e mirë një të kaluar që na solli këtu ku jemi sot. Komunizmi nuk mund të ketë më asnjë hapësirë mes nesh. Në një vend që aspron të jetë pjesë e Perëndimit, pjesë e Europës, nuk mund të ketë mes nesh personazhe të cilët kanë qenë vetë pjesë e ish-Sigurimit të Shtetit, janë bijtë e Sigurimit të Shtetit, sigurisht të atyre që kanë bashkëpunuar me Sigurimin e Shtetit, dhe që kanë qenë palë e atij regjimi ogurzi. Faleminderit!